



**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Fakulteti i Edukimit**

**Programi i studimit:
Mësimdhënia dhe kurrikulat**

Niveli i studimeve:
Master

Numri i kredive:
90 ECTS

Akredituar për periudhën:
1 Tetor 2016- 30 Shtator 2019

Hartimi i këtyre materialeve është bërë me ndihmën e projektit "Modernizimi i Shkollimit të Mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës, nr. 544023" financiar nga Bashkimi Europian.

The European Commission support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents which reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.

PËRMBAJTJA:

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	4
2. REZULTATET E PRITURA.....	5
3. PASQYRË E PROGRAMIT:Mësimdhënia dhe kurrikulat	6
4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS	7

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi Master i Mësimdhënies dhe Kurrikulës fokusohet në kurrikulat¹ dhe procesin e mësimdhënies, me qëllim të përgatitjes së individëve, që do të shërbejnë si ekspertë në kontekstin e tyre profesional. Ky program është planifikuar për studentë që duan t'i thellojnë njohuritë dhe zhvillojnë kapacitetet e tyre, për të reflektuar në mënyrë kritike mbi teoritë e zhvillimit të kurrikulës, hulumtimet në arsim dhe praktikën e tyre profesionale, si dhe duke i aftësuar ata të përballen me sfidat e profesionit të mësimdhënies.

Programi ka për qëllim:

- të përgatisë studentët të jenë kontribuues aktivë në procesin e hartimit dhe rishikimit të kurrikulave, si dhe zbatimin sa më efektiv të tyre, duke pasur për bazë qasjen: mësimdhënia me nxënësin në qendër;
- të përgatisë udhëheqës të ndryshimeve arsimore në klasë dhe shkollë, me fokus të veçantë përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënët;
- të zhvillojë aftësitë e studentëve për të zbatuar programe mësimore, që ofrojnë një ambient të përshtatshëm për të mësuar;
- të zhvillojë kapacitetet e studentëve për zbatimin e strategjive bashkëkohore të mësimdhënies në kontekstin e praktikës së tyre profesionale;
- të përgatisë studentët, që të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin e vazhdueshëm të institucionit të tyre.

¹ Koncepti i kurrikulës në këtë program përdoret në kontekst të qasjes 'poshtë-lartë' të përcaktimit të përmbajtjes mësimore në programet përkatëse, por edhe në kontekstin e studimit të procesit të ndërveprimeve në klasë, duke përfshirë teoritë dhe stilet e të mësuarit dhe vlerësimin e punës së nxënësve në klasë.

2. REZULTATET E PRITURA

- Të zhvillojnë një vetëdije kritike dhe të kuptuarit e avancuar të zbatimit praktik të dhe praktikave moderne të mësimdhënies dhe zhvillimit të politikave kurrikulare duke përfshirë përdorimin e teknologjisë.
- Të zotërojnë aftësi për të planifikuar dhe zbatuar hulumtime të pavarura në fushën e mësimdhënies (krijimin e mësimdhënësit hulumtues) dhe në fushën e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulave.
- Të shqyrtojnë në mënyrë kritike dhe kontribuojnë në proceset e mësimdhënies dhe zhvillimit të kurrikulës, nëpërmjet angazhimit në aktivitetet e zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe kërkesave të legjislacionit arsimor.
- Të aplikojnë standardet për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm të mësimdhënies dhe të nxënit, bazuar në të kuptuarit e raporteve midis teorive dhe politikave kurrikulare.
- Të zhvillojnë një kuptim të thellë dhe sistematik të çështjeve specifike të mësimdhënies, si p.sh: gjithëpërfshirja, komunikimi, aspektet gjinore, përdorimi i teknologjisë informative në mësimdhënie, vlerësimi, puna me projekte, etj..
- Të demonstrojnë të kuptuarit e thellë dhe zbatimin të strategjive të avancuara të mësimdhënies me nxënësin në qendër, duke u bazuar në kërkesat e Kornizës së Kurrikulit të Kosovës.
- Të reflektojnë në mënyrë kritike, analizojnë dhe vlerësojnë teorinë, metodologjitë dhe praktikën e mësimdhënies dhe atyre kurrikulare në fushën e arsimit parauniversitar.
- Të demonstrojnë aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive me mësimdhënësit dhe palët tjera të interesit, për implementimin e Kornizës së Kurrikulit të Kosovës dhe dokumenteve tjerë kurrikularë në praktikë.
- Të analizojnë lidhshmëritë në procesin e arritjes së rezultateve të të nxënit dhe zhvillimit të kompetencave në rrafshin horizontal (fusha kurrikulare) dhe atë vertikal (nivele dhe shkallë kurrikulare) në sistemin parauniversitar.
- Të shqyrtojnë dhe aplikojnë modele bashkëkohore në proceset e vlerësimit të nxënësve, mësimdhënësve, shkollave dhe kurrikulës si tërësi.

3. PASQYRË E PROGRAMIT: Mësimdhënia dhe kurrikulat

VITI I PARË

SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Mësimdhënia: teoria dhe praktika	O	3	7
2.	Teoria dhe politika kurrikulare	O	3	7
3.	Kurs i avancuar në mësimdhënie	O	3	5
4.	Hyrje në hulumtimet arsimore	O	3	6
5.	Arsimi gjithëpërfshirës	Z	3	5
6.	Zhvillimi i kurrikulës dhe mësimdhënia e diferencuar	Z	3	5
7.	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Z	3	5
8.	Psikologji e zbatuar në mësimdhënie	Z	3	5
Gjithsej			15	30

SEMESTRI II

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Metodat e hulumtimeve në arsim	O	3	7
2.	Shkrim akademik dhe kulturë shkrimi	O	3	6
3.	Teknologjitë e edukimit dhe mësimi elektronik	O	3	6
4.	Vlerësimi në arsim	O	3	6
5.	Komunikimi në arsim	Z	3	5
6.	Hulumtimi në veprim	Z	3	5
7.	Mësimi i bazuar në projekte	Z	3	5
8.	Kurrikula e edukimit parashkollor	Z	3	5
Gjithsej			15	30

VITI I DYTË

SEMESTRI III

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Teza e masterit	O		30
Gjithsej				30

4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS

Përshkrimi për secilin kurs	
1	<p>Mësimdhënia: teoria dhe praktika</p> <p>Kursi përqendrohet në përgatitjen teorike dhe praktike të studentëve, për të avancuar mësimdhënien e tyre. Bazuar në diversitetin e pikëpamjeve dhe përvojave, gjatë kursit do të diskutohen çështjet: të mësuarit dhe ndryshimet në arsim, stilet e të nxënit, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, në veçanti metoda sokratike, teoritë e të nxënit (bihevizmi, kognitivizmi, konstruktivizmi dhe humanizmi), modalitetet të nxënit aktiv dhe ndërveprues (të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhja e problemeve), mësimdhënia e individualizuar, mentorimi, mësimi ekipor, të nxënit nga përvoja.</p>
2	<p>Teoria dhe politika kurrikulare</p> <p>Kursi ofron njohuri të avancuara rreth zhvillimeve historike, koncepteve teorike të planifikimit, zhvillimit dhe implementimit të kurrikulave, modelet e kurrikulit dhe reflektimin e tyre në dokumentet kurrikulare në botë dhe Kosovë. Studentët do të kuptojnë konceptet themelore teorike të politikave kurrikulare, do të analizojnë, shpjegojnë, krahasojnë, argumentojnë dhe demonstrojnë njohuri, shprehje e shkathtësi, që ndërlidhen me historikun dhe bazat e kurrikulës, hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulit dhe lidhjen e aspekteve teorike dhe politikave kurrikulare në botë dhe ndërlidhjen e tyre me zhvillimet kurrikulare në Kosovë.</p>
3	<p>Kurs i avancuar në mësimdhënie</p> <p>Ky kurs është plotësim i kursit “Mësimdhënia: teoria & praktika” dhe trajton aspekte të ndryshme dhe tendencat bashkëkohore në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në klasë. Temat kryesore që trajtohen janë: arti i mësimdhënies dhe të nxënit, të nxënit nga përvoja, të mësuarit e bazuar në probleme dhe në projekte, mësimdhënia e bazuar në kompetenca sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (2011), mësimdhënia me nxënësin në qendër, hartimi dhe përdorimi i rezultateve të pritura dhe ndikimi i tyre në procesin e mësimdhënies, si dhe etika dhe të nxënit. Mësimdhënësi i lëndës ruan të drejtën që përmes sillabusit të lëndës të reflektojë aspekte të tjera moderne të mësimdhënies, për të përcjellë trendet moderne, por edhe për të adresuar nevojat e grupit të studentëve.</p>
4	<p>Hyrje në hulumtimet arsimore</p> <p>Kursi trajton një hyrje në fushën e hulumtimeve arsimore, me theks të veçantë në leximin e hulumtimeve dhe të kuptuarit e procesit të hulumtimit shkencor. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i hulumtimeve në arsim, natyra dhe llojet themelore të hulumtimeve, të lexuarit kritik dhe interpretimi i hulumtimeve, formulimi i propozimeve</p>

për hulumtim, përkufizimi i problemeve, formulimi i temave, formulimi i hipotezave, përcaktimi i mostrës, rishikimi i literaturës, instrumentet për mbledhjen e të dhënave, analiza dhe interpretimi i të dhënave, raportimi i hulumtimeve arsimore etj. Studentët do t'u ekspozohen këtyre çështjeve nga këndvështrimi kritik dhe analitik i përgjithshëm, në mënyrë që të njihen me këto koncepte bazë, të cilat do të studiohen dhe zbatohen më në hollësi më vonë gjatë programit.

5 Arsimi gjithëpërfshirës

Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e edukimit inkluziv. Në këtë kurs trajtohen tema, që kanë të bëjnë me përkufizimet bashkëkohore të inkluzionit, të drejtat e njeriut/fëmijës, filozofinë e edukimit inkluziv, format e inkluzionit në vendet e Evropës, mundësitë e krijimit të një shkolle dhe shoqërie inkluzive, etj. Kursi ofron mundësi të debatimit të problemeve, të sfidave të inkluzionit në vende të ndryshme të botës, duke i ndërlidhur me kontekstin kosovar. Ofrohen edhe mundësi të vlerësimit të situatës në institucionet arsimore dhe me gjerë në Kosovë dhe formave të implementimit të edukimit inkluziv. Gjithashtu, zhvillohen shkathtësi të planifikimit të suksesshëm dhe të zbatimit parimeve, strategjive të edukimit inkluziv, të cilat shpjen në drejtim të krijimit të një klase dhe shkolle inkluzive.

6 Zhvillimi i kurrikulës dhe mësimdhënia e diferencuar

Kursi ofrohet për të promovuar qasje të ndryshme të zbrërthimit të kurrikulës në përputhje me procesin e mësimdhënies, duke e përfshirë edhe mësimdhënien e diferencuar. Kursi ofron njohuri dhe shkathtësi për të zbrërthyer kornizën kurrikulare dhe kurrikulën bërthamë, në praktikë, gjatë procesit të planifikimit, organizimit dhe vlerësimit të procesit mësimor. Studentët do të kenë mundësinë të zbatojnë qasje të ndryshme, duke prezantuar rëndësinë e mësimdhënies së diferencuar, integrimin ndërfaqshor, si dhe rolin e mësimdhënësit në zbatimin e mësimin të diferencuar, duke u bazuar në arritjen e Rezultateve të të Nxënësve dhe kompetencave.

Kursi adreson mësimin e diferencuar apo individualizuar, jo vetëm nga perspektiva e integritit dhe inkluzionit, por edhe nga perspektiva e qasjes së mësimdhënies me nxënësin në qendër, duke shfaqur shkallë të lartë në zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ.

7 Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Kursi është përgatitur, në atë mënyrë, që të kuptohen proceset e të mësuarit nga ana e mësimdhënësve, duke ndërlidhur këtë me kërkesat ndaj mësimdhënësve për profesionalizim të punës së mësimdhënësit. Kursi do t'u ofrojë pjesëmarrësve një mundësi për një shqyrtim mbi modelet e

	<p>ndryshme të zhvillimit profesional dhe zgjedhjet që mund të bëjnë menaxherët e shkollave dhe sistemeve të arsimit, në funksion të zhvillimit të një mekanizmi të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, si një mjet për përgatitje profesionale të mësuesve. Kursi ofron mundësi për studentët që të kuptojnë kontekstin e zhvillimit profesional në Kosovë dhe të identifikojnë nevojat e tyre për zhvillim profesional.</p>
8	<p>Psikologji e zbatuar në mësimdhënie</p> <p>Kursi trajton aspektet e lidhura me aspektin personal të nxënësit kundrejt mësimin si motivacioni dhe shtytjes për nxënie. Nga këndvështrimi i teorisë së procesimit të informacionit, ku nxënësi është në qendër të vëmendjes, do të trajtohen edhe metodat psikologjike bashkëkohore mbi përpunimin e të dhënave lidhur me nxënien, rëndësia e njohurive paraprake, mënyre aktuale e të mësuarit dhe ndërlidhja mes tyre, si proces i suksesshëm për përvetësimin e njohurive dhe ruajtjen e tyre afatgjatë. Në psikologjinë e zbatuar në kontekstin mësimdhënie/ mësimnxënie luajnë rol kyç teknikat e ndryshme të nxënies, lidhur me procesin e kushtëzimit operant, andaj do të shpjegohen brenda kursit, ashtu si dhe mënyra e zbatimit të tyre për ngritje të efektivitetit dhe efikasitetit të procesit nxënës. Kursi, po ashtu, trajton edhe aspektet e ndërtimit të raporteve të rëndësishme mes biologjisë dhe psikologjisë, për të arritur e shpjeguar më së miri sjelljen dhe kognicionin njerëzor.</p>
9	<p>Metodat e hulumtimeve në arsim</p> <p>Kursi shqyrton aspektet e përgjithshme teorike dhe metodologjike të të kuptuarit dhe realizimit të një projekti hulumtues në fushën e arsimit. Kursi në njërën anë adreson qasjet dhe orientimet që duhet të zgjedhë hulumtuesi (ontologjia dhe epistemologjia) dhe në anën tjetër adreson aspektet teorike dhe praktike si: definimi dhe formulimi i problemeve hulumtuese; formulimi i pyetjeve hulumtuese dhe hipotezave; hartimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave; analiza dhe interpretimi i të dhënave (duke përfshirë përdorimin e programeve të ndryshme softuerike për analizën e të dhënave); raportimi i hulumtimeve. Kursi adreson edhe aspektet të ndryshme të hulumtimeve kualitative dhe kuantitative dhe shtjellon modele të ndryshme të hulumtimeve si: studime rasti, hulumtime përshkruese, hulumtime etnografike, hulumtime vepruese, hulumtime vlerësuese, etj. Në veçanti, kursi adreson modalitetet e analizës së të dhënave sasiore, përmes përdorimit të programit SPSS si dhe analizën e të dhënave kualitative.</p>
10	<p>Shkrim akademik dhe kulturë shkrimi</p> <p>Kursi përfshin një kurs të rëndësishme nga fusha e kulturës së gjuhës në përgjithësi e të kulturës në të shkruar në veçanti. Po ashtu, studentët do të mësojnë për redaktimin gjuhësor dhe realizimin e projekteve të ndryshme profesionale-shkencore, si dhe të formave të komunikimit profesional etj.,</p>

	<p>gjithnjë duke u mbështetur në shqipen standarde. Kursi ka për fokus ekspozimin e studentëve ndaj çështjeve kryesore të shkrimit të temave të masterit, duke adresuar aspektet e stilit, formatit, përmbajtjes dhe aspekte të tjera gjuhësore. Kursi do t'i adresojë këto çështje nga aspekti praktik, duke synuar që studentët të ndihmohen në temat e tyre eventuale të punimit të tezës së masterit.</p>
1	Teknologjitë e edukimit dhe mësimi elektronik
1	<p>Ky kurs ofron njohuri rreth teknologjive të reja të edukimit për mësimdhënie dhe të nxënësve, si dhe të nxënësve elektronik. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: teknologjitë për mësimdhënie dhe të nxënësve, teknologjitë e edukimit dhe të nxënësve aktiv, teknologjitë e internetit në edukim, simulimet kompjuterike dhe animacionet në edukim, realizimi i eksperimenteve përmes kompjuterit, teknologjitë e bashkëpunimit të mbështetura nga kompjuteri, teknologjinë dhe vlerësimin, të nxënësve elektronik në kontekst, teknologjitë e të nxënësve elektronik, problemet kompatible të aseteve të të mësuarit elektronik, vlerësimi i cilësisë së materialeve të mësimit elektronik.</p>
1	Vlerësimi në arsim
2	<p>Kursi shqyrton aspektet dhe praktikën e vlerësimit, që influencojnë cilësinë e mësimdhënies dhe reformën në shkollë në përgjithësi. Në mënyrë më të theksuar, kursi adreson aspektet e planifikimit dhe realizimit të vlerësimit, sipas qasjes së bazuar në kompetenca në kuadër të reformës kurrikulare në Kosovë. Kursi adreson edhe aspektet tjera të vlerësimit si: natyra dhe qëllimet e vlerësimit, ndërlidhja e vlerësimit me mësimdhënien, llojet e vlerësimit. Për më shumë, kursi trajton në hollësi edhe llojet e ndryshme të vlerësimit si: vlerësimi i vazhdueshëm, vlerësimi për të nxënësve (formativ) dhe vlerësimi i të nxënësve (përmbledhës), si dy koncepte që formësojnë vlerësimin që i bëjnë mësimdhënësit nxënësve, ndërsa nga aspekti praktik, kursi ekspozon nxënësit ndaj metodave të ndryshme të vlerësimit si: vlerësimi i bazuar në portofolio, vlerësimi i punimeve të shkruara, testet dhe cilësia e tyre, etj. Përveç kësaj, kursi adreson edhe aspektet sistematike të vlerësimit si: vlerësimet e jashtme kombëtare dhe vlerësimi i programeve.</p>
1	Komunikimi në arsim
3	<p>Kursi është i dizajnuar të trajtojë problemin e komunikimit në aspektin teorik dhe atë praktik. Komunikimi në arsim trajton çështje si: procesi i komunikimit, komunikimi efektiv, parimet për komunikim të efektshëm, komunikimi kompetent, barrierat për komunikim efektiv, komunikimi interpersonal dhe komunikimi në grup të vogël, shkathtësitë e të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe joverbal (nga perspektiva e nxënësve dhe mësimdhënësve). Në këtë kurs trajtohen edhe faktorët, të cilët ndikojnë në</p>

	komunikimin në arsim dhe shkathtësitë e nevojshme për të krijuar një komunikim të efektshëm në procesin e edukimit, duke përfshirë këtu edhe komunikimin kolegjal me mësimdhënës dhe administratë në shkollë, si dhe komunikimin e jashtëm, si për shembull identifikimi i strategjive të efektshme të komunikimit shkollë-prindër si strategji e përmirësimit të arritjeve të nxënësve dhe zhvillimit të shkollës. Kursi gjithashtu trajton edhe aspektet e zhvillimit të komunikimit dhe bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e gjerë.
1 4	Hulumtimi në veprim Si një nga llojet e hulumtimeve në arsim, hulumtimi në veprim është një komponentë e zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe edukatorëve dhe reflektim kritik i praktikës së tyre profesionale dhe vlerave arsimore. Qëllimi i këtij kursi është përgatitja e studentëve për të përmirësuar praktikatat e tyre, nëpërmjet zhvillimit të projekteve hulumtuese në klasë dhe në institucionet arsimore, ku ata punojnë. Gjatë kursit do të shqyrtohen karakteristikat themelore të hulumtimeve në klasë dhe llojet e tyre, mënyrat e identifikimit të problemeve, hapat e realizimit të hulumtimit në veprim dhe raportimi i tij.
1 5	Mësimi i bazuar në projekte Në këtë kurs do të trajtohen tema si: shkathtësitë e shekullit XXI: përgjegjësia personale dhe shoqërore; planifikimi, të menduarit kritik, rezonimi dhe kreativiteti; shkathtësitë për komunikim me të tjerët; të kuptuarit e kulturave të tjera; vizuelizimi dhe vendimmarrja; njohuri për përdorimin e teknologjisë. Çka është mësimi problemor? Përfitimi nga mësimi i bazuar në projekte. Elemente të mësimit të bazuar në projekte: pyetja, plani, orari i aktiviteteve, monitorimi, vlerësimi dhe reflektimi. Përgatitja e formularëve për formulimin, menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit. Përvojat e ndryshme të zbatimit të mësimit problemor në arsimin e lartë.
1 6	Kurrikula e edukimit parashkollor Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të njihen me rëndësinë e kurrikulës në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve në punën e tyre të përditshme. Do të kenë mundësi që të analizojnë dhe zbërthejnë në praktikë kurrikulën e edukimit parashkollor. Gjithashtu, kursi ofron orientimin e mësimdhënësve parashkollorë për të trajtuar dokumentin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës dhe Kurrikulën Bërthamë 1, në të cilën përfshihet edhe klasa parafillore. Studentët do të përfitojnë njohuri teorike dhe praktike për planifikimin e aktiviteteve bazuar në kompetenca, Rezultatet e të Nxënësve, duke bërë integrimin ndërfaqshor në aktivitetet e tyre. Kursi do të trajtojë edhe format e vlerësimit të kompetencave sipas shkollës.
1	Teza e Masterit

Tema e masterit përmban 30 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit.

Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

1. Tema duhet të ketë 15 000 – 20 000 fjalë, në fontin 12, *Times New Roman, double-spaced*.
2. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
3. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në fushën e shkencave të edukimit, apo aftësimin të mësimdhënësve në profilin e caktuar.
4. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse, duke shfrytëzuar bazën teorike të problemit.
5. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
6. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit, përmes departamentit apo kolegjiut, varësisht si përcaktohet nga aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studenti regjistrohet për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
7. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit, si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të fakultetit dhe për zhvillimin e sistemit shkollor në vend.
8. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
9. Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
10. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për

dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati.

Hollësitë e mëtutjeshme rreth temës së masterit, si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

